2.3.1-a) Per te provuar pervojen e meparshme, kerkohen deshmi per furnizimet e meparshme, te ngjashme, te kryera gjate tri viteve te fundit. Vlera e kerkuar duhet te jete minimum ne nje vlere sa 40% e vleres se perlllogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tri viteve te fundit. Autoriteti kontraktor si deshmi per pervojen e meparshme kerkon vertetime te leshuara nga nje ent publik dhe fatura tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.

OSE

2.3.1-b) Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin privat, si deshmi pranohen vetem faturat tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër shoqërimin me çertifikatë cilësie të leshuara nga një organ i vleresimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, në momentin e dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.3. Operatori Ekonomik Ofertues duhet te paraqes nje Deklarate, ku merr persiper transportin dhe levrimin e mallrave prane ambjenteve magazinuese, sipas kerkesave te Autoritetit Kontraktor.

2.3.4. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar per mallrat objekt prokurimi. Ne rast paraqitje te autorizimit nga distributori, OE duhet te paraqese dokumentacionin per te vertetuar se subjekti ne fjale eshte distributor zyrtar. Autorizimi duhet te jete i leshuar brenda 3 viteve te fundit.

2.3.5. Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqese certifikaten **ISO 9001:2015** te vlefshme mbi “Sistemet e menaxhimit te cilesise” ose ekuivalente per mallrat objekt prokurimi te leshuar nga kompani te cilat njihen nga institucionet zyrtare shqiptare te akredituara.

2.3.6. Ne rastin kur OE ofertues eshte Prodhuesi i mallit, ai duhet të jetë i çertifikuar për sistemin e menaxhimit të cilësisë me çertifikatë **ISO 9001:2015** (ose ekuivalent) për prodhimin e mallrave objekt prokurimi. Certifikata duhet te jete e vlefshme.

2.3.7. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë mostra për të gjithë mallrat e listuar sipas preventivit, ditën dhe orën e zhvillimit të tenderit. Dorëzimi i mostrave do të bëhet pranë Sh.A. UK Lushnje me adresë: Lgj. “18 Tetori”, Rr.”Vath Korreshi”, përballë ish parkut të mallrave, Lushnje.

Mosparaqitja e mostrave të materialeve në përputhje me specifikimet teknike të DST në kohën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor përbën shkak për skualifikim.

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit për mallin që ofron ose test raporte, ku te vertetoje perputhjen e plotë me specifikimet teknike.

2.3.9. Te gjitha mallrat qe kane kontakt me ujin e pijshem duhet të kenë certifikate të aprovimit për përdorimin për ujë të pijshëm (p.sh DVGW, WRAS ose ekuivalente me keto) te vlefshme, nga të paktën 1 institucion kombëtare, ndërkombëtare ose institucione të pavarura certifikuese/testuese.

2.3.10. Operatori ekonomik për vulat e ofruara duhet te paraqese: Certifikate qe verteton se nuk

Dokumentat Standarde të Tenderit

kane permbajtje materialesh toksike dhe nuk jane te demshme per perdoruesin; Raport testimi qe eshte ne perputhje me standartin **ISO 527-2** (Ose ekuivalent); Certificate qe te vertetoje se eshte rezistente ndaj **rrezeve UV**. Te gjitha keto certifikata te jene te leshuara nga institucione kompetente te pavarura certifikues/testues.

2.3.11. Ofertuesi duhet të paraqese dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor ne formën e një table (pjesë e dokumentacionit të specifikimeve teknike), kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë artikujt e Listës. Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr. I produktit	Emertimi i produktit	Emri I kompanise prodhuese	Emri I katalogut	KOD I produktit dhe nr i faqes te dok e noterizuar	Shenim sqarues
-----------------	----------------------	----------------------------	------------------	--	----------------

Plotesimi i gabuar ose mos plotesimi i ofertes teknike per nje ose disa produkte perben kusht per skualifikim.

2.3.12. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose me qera 1 (një) kamione me vinc 5 - 10 ton, me ane te se cilit te deklaroje qe do te marr persiper transportin e mallrave sipas rregullave dhe standarteve te Transportit Rrugor Shqiptar.

Per te vertetuar kete duhet te paraqiten dokumentat si me poshte:

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit (te vlefshme), taksën vjetore, Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit lëshuar nga njësia vendore përkatëse.
- b) Për mjetet e marra me qera, të paraqitet kontrata përkatëse e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt prokurimi, shoqëruar me dokumentin që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme), taksën vjetore, Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit lëshuar nga njësia vendore përkatëse.
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- d) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar.*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 10

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

RAKORDERITE PP

Rakorderite shërbejnë për bashkimin dhe pershtatjen e tubave ose rakorderive plastike me permasa të ndryshme. Trupi i rakorderive të jete material Polipropilen me rezistencë mekanike të lartë. Të suportojnë presionin 16 bar, dhe për këto të jete të testuara sipas standarteve ISO 17885, ISO 1167-1, ISO 1167-4, ISO 3458, ISO 3501 dhe ISO 3503 (ose ekuivalente të tyre). Filetimi I tyre të jete sipas standartit ISO 7-1 (ose ekuivalent). Ndryshimi në dimensionet e produkteve të jete maksimumi ± 0.5 mm nga dimensionet e kerkuara nga AK. Produktet duhet të jete të bombarduara me rreze ultraviolet në mënyrë që mos të krijohen alga ose baktere.

Siperfaqja e brendshme e produkteve duhet te jete homogjene dhe nuk duhet te jete poroze. Produktet nuk duhet te permbajne asnje tip substance qe ndryshojne shijen ose eren e ujit.

Permasat e rakorderive perkatesisht sipas radhes ne preventive jane:

Bashkues pp dn-1/2" pn-16, Bashkues pp 20 dn-1/2" F pn-16, Bashkues pp dn-25-1/2" F pn-16, Bashkues pp dn-25*20 pn-16, Bashkues pp dn-25*25 pn-16, Bashkues pp dn-32 x 1.1/4 "M pn-16, Bashkues pp dn-32 x 20 pn-16, Bashkues pp dn-32 x 25 pn-16, Bashkues pp dn-32 x32 pn-16 kapak per bashkuese 32, Bashkues pp dn-32 x 1 -1/4" F pn-16, Bashkues pp dn-32 x 1 -1/2" F pn-16, Bashkues pp dn-40 x 32 pn-16, Bashkues pp dn-40 x 1" pn-16, Bashkues pp dn-40 x 1 1/2" pn-16 me fileto M pn-16, Bashkues pp dn-40*40 pn-16, Bashkues pp dn-50*25 pn-16, Bashkues pp dn-50*40 pn-16, Bashkues pp dn-50 pn-16, Bashkues pp dn-50 x2" me fileto F pn-16, Bashkues pp dn-50 x2" me fileto M pn-16, Bashkues pp dn-50 x1. 1/4" me fileto M pn-16, Bashkues pp dn-50 x1. 1/2" me fileto M pn-16, Bashkues pp dn-63 mm pn-16, Bashkues pp dn-63/50 mm pn-16, Bashkues pp dn-63 x 1 1/2" me fileto M pn-16, Bashkues pp dn-63 x 2" me fileto M pn-16, Bashkues pp dn-75 x2 " me fileto M pn-16, Bashkues pp dn-75 x90 pn-16, Bashkuese 90 mm pp, Bashkues pp dn-90x 2 1/2" me fileto M pn-16, Bashkues pp dn-90x 3" me fileto M pn-16, Bashkues pp dn-110 x3 " me fileto M pn-16, Brryla Pp dn - 20 x 1/2" pn-16 me fileto M, Brryla Pp dn - 20 x25 mm pn-16 , Brryla Pp dn - 25 x3/4" mm pn-16 me fileto M, Brryla Pp dn-1-1/4" mm pn-16, Brryla Pp dn-40 mm pn-16, Brryla Pp dn - 40 * 1" M mm pn-16, Brryla Pp dn - 50 mm pn-16, Brryla Pp dn - 63 mm pn-16, Tapa Pp dn - 32 mm pn-16 , Tapa Pp dn -40 mm pn-16, Tapa Pp dn - 50 mm pn-16, Tapa Pp dn - 63 mm pn-16, Tapa Pp dn - 75 mm pn-16 , Tapa Pp dn - 90 mm pn-16, Tapa Pp dn-110mm pn-16.

RAKORDERITE ZINGATO

Rakorderite sherbejne per lidhjen dhe/ose degezimin e nje tuboje ose rakorderie me ato tubo ose rakorderi te tjera me permasa te njejta ose te ndryshme. Rakorderite duhet te jene material zingato i tipit EN-GJMW-400-5 (ose ekuivalent) dhe te kene te shkruar ne trup emrin e kompanise prodhuese ose marken. Ato duhet t'i rezistojne nje force minimalisht 35000 N/cm² pa u deformuar, dhe te kene rezistencen gradeformimi te pakten 210 HB. Te jene te mbuluar me zink ne sasi minimalisht 450gr/m² dhe shtresa e zinkut mos te jete me e vogel se 65µm. Filetimi duhet te jene sipas standartit ISO228/1 ose ekuivalent. Presioni qe duhet te durojne te jete minimumi 25 bar ne temperaturen nga -20°C deri ne 100 °C. Te gjithë produktet duhet te jene te certifikuara per perdorim ne uje te pijshem dhe te kene certifikate sanitare. Ato duhet te jene sipas standartit EN10242 (ose ekuivalent).

Permasat e rakorderive perkatesisht sipas radhes ne preventive jane:

Te gjithë permasat e Hollandesve duhet te jene sipas standartit ISO/EN U11 (ose ekuivalent):

Hollandes dn-1" xing, Hollandes dn-1/2" xing, Hollandes dn-2" xing

Te gjithë permasat e Manikotave duhet te jene sipas standartit ISO/EN M2 (ose ekuivalent):

Manikota 1/2" xing, Manikote 1"xing, Manikote 1.1/4"xing, Manikote 2"xing, Manikote 2.1/2"xing, Manikote 3" xing me fileto te plota, Manikote 4" xing me fileto te plota.

Te gjithë permasat e Muftëve duhet te jene sipas standartit ISO/EN N4 (ose ekuivalent):

Mufte 1/2-3/4" xing

Te gjithë permasat e Niple-ve duhet te jene sipas standartit ISO/EN N8 (ose ekuivalent):

Niples 1/2 "xing, Niples 3/4 "xing, Niples 1" xing, Niples 1.1/4" xing, Niples 1.1/2" xing, Niples 2" xing, Niples 3" xing, Niples 4" xing.

Dokumentat Standarde të Tenderit

Te gjithë permasat e Tapave duhet te jene sipas standartit ISO/EN T9 (ose ekuivalent):
Tapa 1/2" xing, Tapa 3/4" xing, Tapa 1" xing, Tapa 1.1/4" xing, Tapa 1.1/2" xing, Tapa 2" xing
Te gjithë permasat e Berrylave fm duhet te jene sipas standartit ISO/EN A4 (ose ekuivalent).
Brryla 1/2" xing F. M, Brryla 1" xing me fileto (F+ M),
Te gjithë permasat e Berrylave ff duhet te jene sipas standartit ISO/EN A1 (ose ekuivalent).
Brryla 1/2" xing, Brryla 3/4" xing, Brryla 1" xing, Brryla 1-1/4" xing, Brryla 1-1/2" xing, Brryla 2.1/2" xing

ELEKTROMANIKOTAT HDPE

Elektromanikotat duhet te jene te prodhuar me plastik HDPE 100 te paster dhe jo plastik te riclikuar. Ato duhet te jene konform standartit EN 12201-3 dhe ISO 4427 (ose ekuivalent). Dendësia e plastikes se perdorur duhet te jete 0.959 g/cm^3 sipas standartit ISO 1183 (ose ekuivalent). Moduli I terheqjes te jete minimumi 900 MPa sipas standartit ISO 527-2 (ose ekuivalent). Presioni I punes, I cili duhet te jete 16 bar, duhet te jete percaktuar ose vendosur sipas standartit EN 12201 (ose ekuivalent).

Permasat e Elektromanikotave perkatesisht sipas radhes ne preventive jane:

Elektromanikota pn-16 Pe Dn - 63 mm, Elektromanikota pn-16 Pe Dn - 75 mm,
Elektromanikota pn-16 Pe Dn - 110 mm, Elektromanikota pn-16 Pe Dn - 140 mm,
Elektromanikota pn-16 Pe Dn - 160 mm, Elektromanikota pn-16 Pe Dn - 180 mm,
Elektromanikota pn-16 Pe Dn - 200 mm.

FASHETAT PP

Fashetat sherbejne per krijimin e daljeve te sigurta ose linjave te reja ne tubat PE-HD sipas kerkeses se klientit. Trupi i fashetave te jete material Polipropilen me rezistence mekanike te larte. Te suportojne presionin 16 bar, dhe per kete te jene te testuara sipas standarteve ISO 13460-1 dhe ISO 1167-1 (ose ekuivalente). Ndryshimi ne dimensionet e produkteve te jete maksimumi $\pm 0.5 \text{ mm}$ nga dimensionet e kerkuara nga AK. Filetimi I tyre te jete sipas standartit ISO 7-1 (ose ekuivalent). Produktet nuk duhet te permbajne asnje tip substance qe ndryshojne shijen ose eren e ujit.

Permasat e fashetave perkatesisht sipas radhes ne preventive jane:

Fashete pp pn-16 dn-40x 1/2" F, Fashete pp pn-16 dn-40x 1" F, Fashete pp pn-16 dn-50x 1/2" F,
Fashete pp pn-16 dn- 50 x 1" F, Fashete pp pn-16 dn-63 x 1" F, Fashete pp pn-16 dn-75 x 1" F,
Fashete pp pn-16 dn-90 x 1" F, Fashete pp pn-16 dn-110 x 1" F, Fashete pp pn-16 dn-140 x 1" F,
Fashete pp pn-16 dn-160 x 1" F, Fashete pp pn-16 dn-200 x 2" F.

TUBOT HDPE (PE100)

Tuba polietileni me dendësi të lartë dhe me permassa sipas preventivit. Te jene sipas standartit EN 12201, ISO 4427 dhe DIN 8074 (ose ekuivalent). Të jenë fleksibël dhe me rezistencë ndaj vibrimeve dhe goditjeve sizmike, për tu përshtatur me relievin e tokës..Të kenë rezistencë të lartë ndaj gërryerjes dhe jetegjatesi te pakten 50 vjet. Dndësia e tubos duhet te jete te pakten

0.955 g/cm³ sipas standartit ISO1183 (ose ekuivalent). Zgjerimi termik linear duhet te jete 1.8 1.8x10⁻⁴ ne 0°C-1 dhe kapaciteti specific I nxhehtesise duhet te jete 1.9 J / g °C. Permbajtja e karbonit ne tubot HDPE te jete nga 2.1% deri ne 2.5% sipas iso 6964 (ose ekuivalent).

Pamja e jashtme: të kenë siperfaqe të lëmuar dhe pa dëmtime, prerja fundore e tubit duhet të jetë e pastër dhe në kënd të drejtë me qëndrën e tubit.

Produktet duhet të kenë certifikate aprovimi nga të paktën 1(një) institucion kombetare osendërkombëtar për përdorimin për ujë të pijshëm (p.sh DVGW).

Permasat dhe presionet e punes se tubove perkatesisht sipas radhes ne preventive jane:

Tubo HDPE Dn-20 Pn 10, Tubo HDPE Dn-50 Pn 10, Tubo HDPE Dn-63 Pn 10, Tubo HDPE Dn-90 Pn 10, Tubo Dn-200 Pn 10, Tubo Dn-40 Hdpe Pn 10.

ALKOL PER ELETROMANIKOTAT

Alkoli etilik duhet te jete me perqendrim te larte 90% (ose me te larte) qe sherben per disinfektimin e tubove perpara se te kryhet ngjitja e tubove me rakorderite.

SARAQINESKA FLUTUR F/M

Saracineskat duhet te jene flutur (jo me leve), prej bronxi, te punojne ne presion 25bar(ose me te larte) dhe ne temperature -15°C deri +115°C. Saraçineskat duhet të kenë mbyllje sferike me kalim të integruar dhe hapje pozicionale. Fundet e saraqineskes duhet te kene filetime te ndryshme (njeri femër dhe tjetri mashkull) dhe te jene konform standartit ISO 228 (ose ekuivalent). Si trupi dhe komponentët e tjetër te saraqineskes duhet te jene prej bronxi. Ne saraqineske duhet te jete e shenuar te dhenat baze si madhesia e saraqineskes, emri I kompanise prodhuese ose I markes etj. Te jene te certifikuara per perdorim per uji te pijshem.

Permasat e Saraçineskave jane:

Saracineska 1/2" ta kete gjatesine minimumi 48mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 30mm. Leva flutur e saraqineskes qe sherben per hapjen dhe mbylljen e saj ta kete gjatesine minimumi 55mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 50mm.

SARAQINESKA ME VOLLANT

Saracineskat duhet te jene me vollant, prej bronxi, te punojne ne presion 25bar(ose me te larte) dhe ne temperature -5°C deri +100°C. Saraçineskat duhet të kenë mbyllje si saraqineskat G. Të dy fundet e saraqineskes duhet te kene filetim femër dhe te jene konform standartit ISO 228 (ose ekuivalent). Si trupi dhe komponentët e tjetër te saraqineskes duhet te jene prej bronxi. Ne saraqineske duhet te jete e shenuar te dhenat baze si madhesia e saraqineskes, emri I kompanise prodhuese ose I markes etj. Te jene te certifikuara per perdorim per uji te pijshem.

Permasat e Saraçineskave jane:

Saracineska 1" ta kete gjatesine minimumi 45mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 22mm. Vollanti i saraqineskes te kete diametrin minimumi 52mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 75mm.

Saracineska 2" ta kete gjatesine minimumi 85mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete

minimumi 44mm. Vollanti i saraqineskes te kete diametrin minimumi 90mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 120mm.

PASTE HIDRAULIKE

Paste filedash hidraulike te jete e pershtatshme per punime hidraulike, te jete me dendesi 0,9-0,95 g/cm³ sipas standartit ASTM D1298 (ose ekuivalent), e patretshme ne uje dhe jo gerryese. Pika e ndezjes te jete me e larte se 230 C. Paketimi te jete minimumi 500g.

KUNDRAVALVUL

Kundralvula te jete material 100% bronx .Mekanizmi I bllokimit te rrjedhjes se ujit ne te kundert duhet te jete I veshur me gomine. Presioni i punes te jete minimumi 20 bar dhe temperatura e punes -10°C deri +110°C. Të dy fundet e kundralvules duhet te kene filetim femër dhe te jene konform standartit ISO 228 (ose ekuivalent). Kundralvula duhet te kete te shenuar te dhenat baze ne trup si madhesia e saj, drejtimin e rrjedhjes etj. Kundralvulat duhe te jene te certifikuar per perdorim per uji te pijshem.

Permasat e Kundralvulave perkatesisht sipas radhes ne preventive jane:

Kundralvula 1" ta kete gjatesine minimumi 66mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 28mm. Lartesia totale te jete minimumi 72mm.

KUNDRAVALVUL THITHESE

Kundralvula te jete material 100% bronx .Mekanizmi I bllokimit te rrjedhjes se ujit ne te kundert duhet te jete bronxi. Presioni i punes te jete deri ne 25 bar dhe temperatura e punes -10°C deri +110°C. Të dy fundet e kundralvules duhet te kene filetim femër dhe te jene konform standartit ISO 228 (ose ekuivalent). Kundralvula duhet te kete te shenuar te dhenat baze ne trup si madhesia e saj, drejtimin e rrjedhjes etj. Kundralvulat duhe te jene te certifikuar per perdorim per uji te pijshem.

Permasat e Kundralvulave perkatesisht sipas radhes ne preventive jane:

Kundralvul thithese 2" ta kete gjatesine minimumi 115mm dhe gjeresia totale e produktit te jete maksimumi 80mm.

Kundralvul thithese 1 e 1/4" ta kete gjatesine minimumi 90mm dhe gjeresia totale e produktit te jete maksimumi 58mm.

VULA PER MATESAT

Pjesa e brendshme me ngjyre e vules te jete e bllokuar brenda vules me ane te ngjitjes me vibrime akustike me frekuence te larte, e cila siguron puthitjen sa me te mire te vules, dhe siguri sa me te larte. Numrat serial dhe logoja ne vule te jene te shenuara me ane te nje shenjuesi me lazer dhe te mos kene mundesi te fshihen nga perdoruesit. Trupi I vules te jete material Polikarbonat I klasit V2 (per ti rezistuar flakeve) dhe pjesa e brendshme me ngjyre te jete

Dokumentat Standarde të Tenderit


material poliacetal I standartit ASTM F 1855. Vula duhet ti rezistojë kushteve ekstreme të motit pa problem -38°C - $+80^{\circ}\text{C}$.

Vula të jete të testuar për fortesinë e saj sipas standartit ISO 527-2. Gjate testimeve të jete të treguar se vula duron pa u thyer një forcë mesatare prej minimalisht 37 kilogram forcë. Kjo duhet të vertetuar nga një certificate/test raport nga shoqëria (kompani) të pavarura testuese dhe certifikuese ndërkombëtare.

Vula duhet të përmbushë kërkesat e standartit ISO 4892-3. Vula duhet të jete testuar dhe të rezistojë rrezeve ultraviolette. Gjate testimeve vula duhet të ketë rezistuar për minimalisht 7 orë rrezeve ultraviolette me intensitet minimal $0.75\text{W}/\text{m}^2$ dhe me gjatësi vale rrezatimi 340 nanometër në temperaturë $57-63^{\circ}\text{C}$. Mbas testimeve vula nuk duhet të ketë pësuar asnjë ndryshim në formën fizike të saj. Kjo duhet të vertetuar nga një certificate/test raport nga shoqëria (kompani) të pavarura testuese dhe certifikuese ndërkombëtare.

Për shkak të përdorimit të gjërë të tyre dhe në mjedise të ndryshme ku mund të kenë akses persona të ndryshëm vulat nuk duhet të jenë të demshme për shëndetin dhe nuk duhet të kenë në përberje të tyre material të demshëm ose toksik për jetën e njeriut.

Vula duhet të ketë logon “Ujesjelles Kanalizime”, 8 numra serial unik të njëpasnjëshëm në pjesën e përparme të trupit (pjesa femërore) dhe 4 shifrat e fundit në pjesën e brendshme me ngjyrë.



Vula duhet të shoqërohet së bashku me telin e galvanizuar dhe të plastifikuar. Çdo vule duhet të shoqërohet me minimumi 60 cm tel.

GUARNICIONE

Guarnicionet duhet të suportojnë presione 16 bar. Ato duhet të jenë sipas standartit EN 681-1 (ose ekuivalent) që edhe të kenë markimin CE. Materiali i guarnicionit duhet të jete EPDM si dhe të ketë të shënuar në trup emrin e prodhuesit, diametrin, presionin e punës dhe materialin. Temperatura e punës të jete deri në 70°C (nese produkti punon edhe në temperatura më të lartë do të jete e pranueshme).

AJRUES 2" (50mm) dhe (80mm)

Dokumentat Standarde të Tenderit

Ajruesit lejojnë nxjerrjen e ajrit në sistemet e shpërndarjes së ujit. I gjithë trupi i ajruesit sëbashku me kapakun duhet të jetë gize EN-GJS-400 sipas standartit EN 1563 (ose ekuivalent). Ajruesi duhet të ketë valvulë e nxjerrjen e ajrit, të ketë një valvulë shkarkuese dhe një valvulë sigurie. Ai duhet të kryejë 3 funksione, shkarkimin e errymave të mëdha të ajrit gjatë mbushjes së tubave, nxjerrjen automatike të ajrit që gjendet në tuba me ujë me presion dhe nxjerrjen e ajrit që gjendet në tuba gjatë zbrastjes ose boshatisjes së tyre. Valvula e sigurisë dhe valvula shkarkuese duhet të jenë material bronxi ose inoks. Valvula qendrore për shkarkimin e ajrit duhet të ketë materialin izolues gome për ajruesin 50mm dhe polietilen për ajruesin 80mm. Dadot dhe bulonat të jenë material i pandryshkshëm, çelik i galvanizuar ose inoks. Ajruesit duhet të jenë të lyera ose të veshura me bojë epokside Brenda dhe jashtë sipas standartit DIN 30677 (ose ekuivalente). Ajruesit të jenë me fllanxha sipas standartit EN 1092-2 (ose ekuivalent) dhe të jenë të testuar sipas standarteve EN 12266 dhe EN 1074-1 & -4 (ose ekuivalente). Presioni i punës duhet të jetë 25bar.

Permasat e ajruesve sipas listës në preventiv.

Ajrues 2" (50mm) dhe 80mm.

BERRYLA GIZE

Berrylat janë rakorderi që bëjnë të mundur lidhjen e një tuboje ose rakorderie me ato tubo ose rakorderi të tjerë që kanë një kënd 90 gradë ndërmjet tyre. Berrylat duhet të jenë material gize EN-GJS-500-7 (ose ekuivalent) sipas standartit EN 545 (ose ekuivalent). Berrylat duhet të jenë të lyera ose të veshura me bojë epokside minimum 250µm. Presioni i punës së berrylave të jetë 16 bar (ose më i lartë). Lidhjet fundore të fllanxhave të berrylave duhet të jenë sipas standarteve ISO 2531:1991, DIN2501 dhe EN1092-2 (ose ekuivalent).

Permasat e berrylave përkatesisht sipas radhës në preventive janë:

Brryla (Ø250) me trashësi të metalit nga 9-810mm dhe me peshe 50-55kg.

Brryla (Ø200) me trashësi të metalit nga 8-8.5mm dhe me peshe 30-33kg.

Brryla (Ø150) me trashësi të metalit nga 7.5-8mm dhe me peshe 20-22kg.

Brryla (Ø125) me trashësi të metalit nga 7.2-7.8mm dhe me peshe 15-17kg.

Brryla (Ø100) me trashësi të metalit nga 7-7.5mm dhe me peshe 10-12kg.

Brryla (Ø80) me trashësi të metalit nga 7-7.5mm dhe me peshe 9-11kg.

Brryla (Ø50) me trashësi të metalit nga 7-7.5mm dhe me peshe 6-8kg.

FLLANXHAT

Fllanxhat duhet të jenë të sheshta dhe sipas standartit 1092-1 (ose ekuivalent). Të gjitha fllanxhat duhet të kenë presion pune 16bar. Permasat e fllanxhave përkatesisht sipas radhës në preventive janë:

Fllanxha (Ø500), Fllanxha (Ø350), Fllanxha (Ø300), Fllanxha (Ø250), Fllanxha (Ø200), Fllanxha (Ø150), Fllanxha (Ø125), Fllanxha (Ø100), Fllanxha (Ø80), Fllanxha (Ø50).

XHUNTO CMONTIMI

Xhuntot e cmontimit sherbejne per cmontimin dhe instalimin e lehte dhe te sigurt te rakorderive ne tubot e linjave shperndarese te ujit. Te treja fllanxhat e xhuntos se cmontimit duhet te jene material gize EN-GJS-500-7 (ose ekuivalent) sipas standartit EN 1563 (ose ekuivalent). Ato duhet te jene ne perputhje standartit EN 1092-2 (ose ekuivalent). Presioni I punes duhet te jete 16 bar (ose me I larte). Xhuntot duhet te kene guarnicionet sipas standartit EN 681-1 (ose ekuivalent) qe edhe te kene markimin CE. Materiali I guarnicionit duhet te jete EPDM. Dadot, bulonat dhe rondelet te jene sipas standartit ISO 898 (ose ekuivalent). Xhuntot duhet te jene te lyera ose te veshura me boje epokside minimum 250µm sipas standartit DIN 30677 (ose ekuivalente).

Permasat e xhuntove te cmontimit perkatesisht sipas radhes ne preventive jane:

Xhunto cmontimi (Ø500mm) me distance nga fllanxhat fundore 285mm dhe peshe 200-220kg.
Xhunto cmontimi (Ø350mm) me distance nga fllanxhat fundore 255mm dhe peshe 100-110kg.
Xhunto cmontimi (Ø300mm) me distance nga fllanxhat fundore 245mm dhe peshe 70-80kg.
Xhunto cmontimi (Ø250mm) me distance nga fllanxhat fundore 245mm dhe peshe 60-70kg.
Xhunto cmontimi (Ø200mm) me distance nga fllanxhat fundore 245mm dhe peshe 45-50kg.
Xhunto cmontimi (Ø150mm) me distance nga fllanxhat fundore 225mm dhe peshe 30-35kg.
Xhunto cmontimi (Ø125mm) me distance nga fllanxhat fundore 225mm dhe peshe 20-25kg.
Xhunto cmontimi (Ø100mm) me distance nga fllanxhat fundore 225mm dhe peshe 20-22kg.
Xhunto cmontimi (Ø80mm) me distance nga fllanxhat fundore 225mm dhe peshe 18-20kg.
Xhunto cmontimi (Ø50mm) me distance nga fllanxhat fundore 205mm dhe peshe 10-11kg.

BASHKUESE UNIVERSALE

Bashkueset universale sherbejne per te bashkuar ose lidhur tubo PE, PVC, gize , cimento, celiku, me fibra xhami etj.. ndermjet tyre. Bashkueset duhet ofrojne garanci dhe siguri te bashkimit te tubove me ane te elementeve te ndryshem shtese qe kane ne sektorin e mberthimit dhe shtrengimit te tubove. Bashkueset duhet te ofrojne nje tolerance midis dy aneve te bashkimit te tubove prej 8 gradesh ose me te larte, pa krijuar asnje problem. Trupi I bashkueseve dhe unazat shtrenguese te jene material gize EN-GJS-500 sipas standartit EN 1563 (ose ekuivalent). Gomina izoluese e bashkueses duhet te jete EPDM per perdorim per uji te pijshem sipas standartit EN 681-1 (ose ekuivalent). Kapset e bashkueseve duhet te jete material POM. Bashkueset duhet te kene thumba te dhembzuar te cilet te jene material celiku DIN 1.1132 (ose ekuivalent) sipas standartit DIN 1654 (ose ekuivalent me te) dhe qe sigurojne nje lidhje te qendrushme te tubos me bashkuesen. Bulonat dhe rondelet te jene material I pandryshkshem inoks A2 sipas standartit EN 10088-1(ose ekuivalent) ndersa dado te jete material I pandryshkshem inoks A4 sipas standartit EN 10088-1(ose ekuivalent). Bashkuesja duhet te jete e lyer ose e veshur me boje epokside qe lejohet per uji te pijshem me trashesi lyerje minimum 250µm sipas standartit DIN 30677 (ose ekuivalent). Bashkueset duhet te jene te testuara sipas standartit EN 14525 dhe EN 545 (ose ekuivalente) dhe te kene presion pune 16 bar ose me te larte.

Permasat e bashkueseve universale perkatesisht sipas radhes ne preventive jane:

Diapazoni I punes te jete 172-202mm (pranohen edhe produkte me diapazone me te medha qe e perfshijne diapazonin e kerkuar). Gjatesia e produktit te jete te pakten 30cm. Peshja e produktit te jete minimumi 22 kg.

Diapazoni I punes te jete 138-168mm (pranohen edhe produkte me diapazone me te medha qe e

perfshijne diapazonin e kerkuar). Gjatesia e produktit te jete te pakten 30cm. Pesha e produktit te jete minimumi 20kg.

Diapazoni I punes te jete 87-117mm (pranohen edhe produkte me diapazone me te medha qe e perfshijne diapazonin e kerkuar). Gjatesia e produktit te jete te pakten 25cm. Pesha e produktit te jete minimumi 14kg.

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca11

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Mall:		Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes
Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Dokumentat Standarde të Tenderit

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

NR.	Emërtimi	NJESIA	SASIA	ÇMIMI NJESI	VLERA
1	Bashkues pp dn-20*20 pn-16	Cope	3000		
2	Gomina per matesa 1/2 p	Pako	100		
3	Gomina per matesa 3/4	Pako	30		
4	Bashkues pp 20 dn-1/2" F pn-16	Cope	10		
5	Bashkues pp dn-25-1/2" F pn-16	Cope	10		
6	Bashkues pp dn-25*20 pn-16	Cope	10		
7	Bashkues pp dn-25*25 pn-16	Cope	200		
8	Bashkues pp dn-32 x 1.1/4 " M pn-16	Cope	100		
9	Bashkues pp dn-32 x 20 pn-16	Cope	10		
10	Bashkues pp dn-32 x 25 pn-16	copë	50		
11	Bashkues pp dn-32 x32 pn-16	Cope	50		
12	kapak per bashkuese 32	Cope	10000		
13	Bashkues pp dn-32 x 1 -1/4" F pn-16	Cope	50		
14	Bashkues pp dn-32 x 1 -1/2" F pn-16	Cope	50		
15	Bashkues pp dn-40 x 32 pn-16	Cope	50		
16	Bashkues pp dn-40 x 1 " pn-16	Cope	1000		
17	Bashkues pp dn-40 x 1 1/2" pn-16me fileto M pn-16	Cope	50		
18	Bashkues pp dn-40 *40 pn-16	Cope	200		
19	Bashkues pp dn-50 *25 pn-16	Cope	20		
20	Bashkues pp dn-50 *40 pn-16	Cope	10		
21	Bashkues pp dn-50 pn-16	Cope	200		

Dokumentat Standarde të Tenderit

22	Bashkues pp dn-50 x2 " me fileto F pn-16	Cope	100		
23	Bashkues pp dn-50 x2 " me fileto M pn-16	Cope	10		
24	Bashkues pp dn-50 x1. 1/4 " me fileto M pn-16	Cope	100		
25	Bashkues pp dn-50 x1. 1/2 " me fileto M pn-16	Cope	50		
26	Bashkues pp dn-63 mm pn-16	Cope	50		
27	Bashkues pp dn-63*50 mm pn-16	Cope	30		
28	Bashkues pp dn-63 x 1 1/2"me fileto M pn-16	Cope	50		
29	Bashkues pp dn-63 x 2"me fileto M pn-16	Cope	100		
30	Bashkues pp dn-75 x2 "me fileto M pn-16	Cope	10		
31	Bashkues pp dn-75 x90pn-16	Cope	10		
32	Bashkuese 90 mm pp	Cope	50		
33	Bashkues pp dn-90x 2 1/2"me fileto M pn-16	Cope	10		
34	Bashkues pp dn-90x 3"me fileto M pn-16	Cope	10		
35	Bashkues pp dn-110 x3 " me fileto M pn-16	Cope	5		
36	Brryla Pp dn - 20 x 1/2 " pn-16 me fileto M	Cope	2000		
37	Brryla Pp dn - 20 x25 mm pn-16	Cope	100		
38	Brryla Pp dn - 25 x3/4" mm pn-16 me fileto M	Cope	50		
39	Brryla Pp dn - 1-1/4" mm pn-16	Cope	50		
40	Brryla Pp dn - 40 mm pn-16	Cope	800		
41	Brryla Pp dn - 40 * 1" M mm pn-16	Cope	200		
42	Brryla Pp dn - 50 mm pn-16	Cope	200		
43	Brryla Pp dn - 63 mm pn-16	Cope	200		
44	Tapa Pp dn - 32 mm pn-16	Cope	50		
45	Tapa Pp, dn -40 mm pn-16	Cope	500		
46	Tapa Pp dn - 50 mm pn-16	Cope	300		
47	Tapa Pp dn - 63 mm pn-16	Cope	50		
48	Tapa Pp dn - 75 mm pn-16	Cope	20		
49	Tapa Pp, dn - 90 mm pn-16	Cope	3		
50	Tapa Pp ,dn - 110mm pn-16	Cope	2		
51	Manikota 1/2" xing	Cope	500		
52	Hollandes dn-1" xing	Cope	20		
53	Hollandes dn-1/2" xing	Cope	20		
54	Hollandes dn-2" xing	Cope	20		
55	Manikote 1"xing	Cope	200		
56	Manikote 1.1/4"xing	Cope	30		
57	Manikote 2"xing	Cope	30		
58	Manikote 2.1/2"xing	Cope	5		
59	Manikote 3" xing me fileto te plota	Cope	5		
60	Manikote 4" xing me fileto te plota	Cope	2		
61	Mufte 1/2-3/4" xing	Cope	1000		
62	Niples 1/2 "xing	Cope	500		
63	Niples 3/4 "xing	Cope	100		
64	Niples 1" xing	Cope	200		

Dokumentat Standarde të Tenderit

65	Niples 1.1/4" xing	Cope	10		
66	Niples 1.1/2" xing	Cope	50		
67	Niples 2" xing	Cope	50		
68	Niples 3" xing	Cope	5		
69	Niples 4" xing	Cope	2		
70	Tapa 1/2" xing	Cope	5000		
71	Tapa 3/4" xing	Cope	1000		
72	Tapa 1" xing	Cope	100		
73	Tapa 1.1/4" xing	Cope	50		
74	Tapa 1.1/2" xing	Cope	50		
75	Tapa 2" xing	Cope	50		
76	Brryla 1/2" xing	Cope	200		
77	Brryla 1/2" xing F. M	Cope	200		
78	Brryla 3/4" xing	Cope	50		
79	Brryla 1" xing	Cope	100		
80	Brryla 1" xing me fileto(F+ M)	Cope	150		
81	Brryla 1-1/4" xing	Cope	60		
82	Brryla 1-1/2" xing	Cope	50		
83	Brryla 2" xing me fileto(F+ M)	Cope	100		
84	Brryla 2.1/2" xing	Cope	20		
85	Elektromanikota pn-16 Pe Dn - 63 mm	Cope	2		
86	Elektromanikota pn-16 Pe Dn - 75 mm	Cope	2		
87	Elektromanikota pn-16 Pe Dn - 110 mm	Cope	2		
88	Elektromanikota pn-16 Pe Dn - 140 mm	Cope	10		
89	Elektromanikota pn-16 Pe Dn - 160 mm	Cope	10		
90	Elektromanikota pn-16 Pe Dn - 180 mm	Cope	2		
91	Elektromanikota pn-16 Pe Dn - 200 mm	Cope	10		
92	Fashete pp ,pn-16 dn-40x 1/2" F	Cope	3000		
93	Fashete pp ,pn-16 dn-40x 1" F	Cope	100		
94	Fashete pp ,pn-16 dn-50x 1/2" F	Cope	500		
95	Fashete pp ,pn-16 dn- 50 x 1" F	Cope	5		
96	Fashete pp pn-16 dn-63 x 1 " F	Cope	5		
97	Fashete pp pn-16 dn-75 x 1" F	Cope	5		
98	Fashete pp pn-16 dn-90 x 1 " F	Cope	5		
99	Fashete pp pn-16 dn-110 x1 " F	Cope	5		
100	Fashete pp pn-16 dn-140 x 1 " F	Cope	5		
101	Fashete pp pn-16 dn-160 x 1 " F	Cope	10		
102	Fashete pp pn-16 dn-200 x2 " F	Cope	5		
103	Tubo Dn-20 ,Hdpe Pn 10	ml	5000		
104	Tubo Dn-50,Hdpe Pn 10	ml	500		
105	Tubo Dn-63,Hdpe Pn 10	ml	500		
106	Tubo Dn-90 ,Hdpe Pn 10	ml	200		
107	Tubo Dn-200 Hdpe Pn 10	ml	50		

Dokumentat Standarde të Tenderit

108	Tube Dn-40 Hdpe Pn 10	ml	1000		
109	Alkol per elektromanikota	Kg	10		
110	Saracineska bronxi dn-1/2 " flutur F.M.	Cope	500		
111	Saracineska 1" me vollant	Cope	200		
112	Saracinesk dn-2" bronxi me volland	Cope	10		
113	Paste hidraulike	Cope	50		
114	Fije lini	Tufa	100		
115	Kundravalvul (1\1\4)	Cope	7		
116	Kundravalvul thithese 2 poleshe	Cope	10		
117	Kundravalvul (1\1\4) thithese	Cope	20		
118	Vula per matesat	Cope	15000		
119	Guarnicione (Ø500)	Cope	40		
120	Guarnicione (Ø350)	Cope	40		
121	Guarnicione (Ø300)	Cope	30		
122	Guarnicione (Ø250)	Cope	30		
123	Guarnicione (Ø200)	Cope	70		
124	Guarnicione (Ø150)	Cope	140		
125	Guarnicione (Ø125)	Cope	32		
126	Guarnicione (Ø100)	cope	420		
127	Guarnicione (Ø80)	cope	140		
128	Guarnicione (Ø50)	cope	90		
129	Ajrues dn 80 mm pn 20	cope	7		
130	Ajrues dn 2 " pn 20	cope	25		
131	Ajrues dn 1/4 " pn 20	cope	25		
132	Brryla (Ø250) gize	cope	20		
133	Brryla (Ø200) gize	cope	40		
134	Brryla (Ø150) gize	cope	40		
135	Brryla (Ø125) gize	cope	40		
136	Brryla (Ø100) gize	cope	40		
137	Brryla (Ø80) gize	cope	40		
138	Brryla (Ø50) gize	cope	40		
139	Fllanxha (Ø500)	cope	4		
140	Fllanxha (Ø350)	cope	4		
141	Fllanxha (Ø300)	cope	6		
142	Fllanxha (Ø250)	cope	10		
143	Fllanxha (Ø200)	cope	20		
144	Fllanxha (Ø150)	cope	20		
145	Fllanxha (Ø125)	cope	20		
146	Fllanxha (Ø100)	cope	20		
147	Fllanxha (Ø80)	cope	20		
148	Fllanxha (Ø50)	cope	20		
149	Xhunto cmontimi (Ø500)	cope	1		
150	Xhunto cmontimi (Ø350)	cope	2		

Dokumentat Standarde të Tenderit

151	Xhunto cmontimi (Ø300)	cope	2		
152	Xhunto cmontimi (Ø250)	cope	7		
153	Xhunto cmontimi (Ø200)	cope	10		
154	Xhunto cmontimi (Ø150)	cope	15		
155	Xhunto cmontimi (Ø125)	cope	15		
156	Xhunto cmontimi (Ø100)	cope	15		
157	Xhunto cmontimi (Ø80)	cope	15		
158	Xhunto cmontimi (Ø50)	cope	15		
159	Bashkuese universale me diapazon 172mm-202mm	cope	2		
160	Bashkuese universale me diapazon 138mm-168mm	cope	2		
161	Bashkuese universale me diapazon 87mm-117mm	cope	2		
SHUMA PA TVSH					
TVSH 20%					
TOTAL ME TVSH					

Afatet e lëvrimit: 12 muaj nga datan e lidhjes se Draft – Marreveshjes, sipas nevojave dhe kerkesave te Autoritetit Kontraktor.

Shtojca 13

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Dokumentat Standarde të Tenderit

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

* * *

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

- | | |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____ | _____ |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- | | |
|----------|-------|
| 1. _____ | _____ |
|----------|-------|

Dokumentat Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. __

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat – Tender i Hapur

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi,

Dokumentat Standarde të Tenderit

tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikant e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

